



Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi	Datë: 07.11.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)
---	-------------------------	--

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë	
Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë KPK). Objekti: Procesi i Vettingut të subjektit të rivlerësimit Znj. Miranda Nakaj</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>Znj. Miranda Nakaj</i>
pozicioni i punës/ qyteti nese nuk është Tirana	<i>Ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apeli, Tiranë</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca u zhvillua e plotë, në distancë kohore 25 minuta (10:00-10:25), pa proceduar me shtyrje të saj. Trupa gjyquese e KPK tërhiqet për të marrë vendimin, shpallja e të cilit është shtyrë për ditën e nesërme</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Shpallja e vendimit është shtyrë për ditën e nesërme (dt. 08 nëntor, ora 10:00)</i>

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca	
Trupa gjyquese (emrat)	<i>Roland Ilija - Kryetar i trupit gjyques; Brunilda Bektashi - Relatore e çështjes; Xhensila Pine - anëtare e trupit gjyques; asistohen nga sekretarja gjyqësore- Anisa Duka. prezent pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore</i>
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar paraqitet, Znj. Elka Ermenkova, prezente pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore</i>
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Mbrojtja u realizua me anë të përfaqësueses ligjore Znj. Brunela Kullolli. Prezente pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore. Konfirmohet me Deklarim në seancë dëgjimore</i>
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Albana Misja</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Numri i anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 10 persona, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye ne formë të rregullt nga stafi koordinues i KPK. Prezent pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore</i>
Media e pranishme:	<i>Mediat lokale janë të pranishme, me përfaqësues, me akses të plotë ne hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u lejua vetëm në fazën përgatitore të seancës dëgjimore, pas së cilës iu komunikua nga kryetari i trupit gjyques, të largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit</i>

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vetingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Po	<i>Trupa gjyquese vendosi të përfundoj hetimin administrativ kryesisht, për të tre kriteret e rivlerësimit: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike</i>	<i>Subjekti i rivlerësimit e cilësoj metodologjinë e procedurës së ndjekur nga KPK, të rregullt e të paanshme, duke pranuar përfundimet e hetimit administrativ të KPK. Konfirmoj vënie në dijeni me rezultatet, materialet e dosjes dhe dokumentet provues të hetimit administrativ, si edhe marrjen e një kopjeje të tyre. Konfirmoj se nuk cënohen asnjë ndër rastet ligjore të konfliktit të interesave me anëtarët e trupit gjyques, dhe nuk ka pretendime sa i takon përjashtimit të tyre. Konfirmoj njoftimin për seancën dëgjimore brenda një kohe të mjaftueshme me qëllim dokumentimin përfundimtar me shkrim të pretendimeve, të cilën e depozitoj në formë të shkruar, pranë sekretarisë gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.</i>

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	<p>Pasuria e deklaruar në deklaratën Vetting rezulton:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Pasuria totale e deklaruar- asnjë pasuri. 2- Të ardhura totale nga pagat: 5,959,000 lekë. 3- Kredi konsumatore pranë Raiffeisen Bank: 810.000 lekë. 4- Kartë krediti në Raiffeisen Bank në shumën 500 euro 5- Super Kredi me objekt rregullim shtëpie, pranë BKT: 500,000 lekë. Overdraft në shumën 78 mijë lekë. <p>Përfundimisht konstatohet se: Subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.</p> <p>Megjithatë vlerësohet se nuk ka kryer Deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, (në Deklaratën Vetting) sa i takon disa ambienteve të banimit ku subjekti ka banuar në periudhën 2010-2013, kohë gjatë së cilës ka ushtruar profesionin e Avokates së Shtetit pranë Avokaturës së Shtetit.</p>	Të dhëna nga raportet e ILDKPKI	<p>Provat e administruara në seancën dëgjimore: Raporti i ILDKPKI, të dhëna të tjera (deklarata) nga subjekti i rivlerësimit, informacione shkresore marrë nga institucionet publike, dokumente të tjerë të dosjes. Referohen në seancë dëgjimore nga Relatorja e trupit gjykues. Komunikuar njohja e tyre subjektit të rivlerësimit (respektuar parimi i aksesit në gjykim dhe e drejta e mbrojtjes efektive).</p>
	<p>Relatorja e çështjes, Znj. Bekteshi, referon Raportet e ILDKPKI, saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, dhe konkluzionet përfundimtare të hetimit administrativ kryer në formë të pavarur nga KPK, sa më poshtë: Subjekti i rivlerësimit ka burim të ligjshëm të të ardhurave, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë, nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit, dhe ka bashkëpunuar gjatë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit. Gjithashtu, në ndryshim nga konstatimet e Raportit të ILDKPKI, ka bërë Deklarim të saktë të pasurisë. Arsyetimi bazohet në faktin që Raportimi i ILDKPKI i referohet mos deklarimit nga subjekti i adresave të banimit, gjatë periudhës 2010-2013 kur ka punuar si Avokate shteti pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit. Referuar inspektimeve të KPK, është konkluduar se këto banesa nuk kanë qenë në pronësi apo me qira të subjektit të rivlerësimit. përpara periudhës 2010, para angazhimit në profilin e avokates së shtetit, është deklaruar si shtëpi banimi apartament në pronësi të të atit të subjektit të rivlerësimit, Referuar konstatimeve të KPK, në përfundim të hetimit, KPK vendos se nuk ka dyshime të pasurive të paluajtshme në përdorim, pronësi apo dhënë me qira, në lidhje me deklaratimet e bëra në deklaratën Veting. Në lidhje me banesat e padeklaruar në Deklaratën Vetting, KPK konfirmon deklaratimet e subjektit, si dhe konfirmon gjendjen e kredive.</p>	Relatori	
	nuk ka	Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentet provues. Miraton deklaratimet e KPK mbi përfundimet e hetimit administrativ	Subjekti i rivlerësimit	
	nuk ka	Ankesa nga publiku	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Të dhëna nga raporti i DSIK, dhe verifikimet e grupit të punës: konstatojnë vlerësimin: "I Përshtatshëm" për vazhdimin e zhvillimit të detyrës	Të dhëna nga raportet e DSIK	<p>Raporti Drejtorisë së Sigurisë dhe Informacionit të Klasifikuar, dhe verifikimet e grupit të punës</p>
	Relatorja e çështjes, referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr.84/2016, dhe të provave si më sipër, deklararon "Përshtatshmërinë" në vazhdimin e detyrës.	Relatori	
	nuk ka	Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentet provues. Miraton deklaratimet e KPK mbi përfundimet e hetimit administrativ	Subjekti i rivlerësimit	
	nuk ka	Ankesa nga publiku	
	Përfaqësuesi i ONM pyetet për pretendime, sqarime/ pyetje të mëtejshme nga kryetarja e trupit gjykues të KPK. Konfirmon se nuk ka pyetje për subjektin e rivlerësimit	Përfaqësuesi i ONM	

D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Të dhënat marrë nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë: në Raporte pretendohet se nuk ka bazë ligjore për të mbështetur kërkesat e ligjit, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të ndihmësve ligjor (përcaktimi i standardeve minimale të punës për ndihmësit ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit)	Të dhëna nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	Provat e administruara në seancë dëgjimore: Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale të Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura në formë rastësore; të dhëna nga burimet arkivore të KLD; Rezultatet e testimit të Shkollës së Magjistraturës
	Relatorja parashton burimin e të dhënave dhe vlerësimin përfundimtar të tyre: arsyeton në kundërshtim me vlerësimin e KLD, duke iu referuar bazës ligjore Neni 6 I ligjit nr. 49/2012, lidhur me detyrat e ndihmësve ligjor, dhe i kërkoj shpjegime subjektivit si dhe akte shtesë. Sa më sipër i kërkohet rivlerësim i tyre Inspektoriatit të KLD, i cili hartoj raport shtese ku përfshihen mendime pozitive nga një gjyqtare relatores, shoqëruar ky me një mendim jo pozitiv të një gjyqtare tjetër relatores. U morën parasysht edhe rezultatet e provimit të Shkollës së Magjistraturës e vlerësuar me 61 pikë në fazën e parë dhe 139 pikë në fazën e dytë. Në kuadër të kalimit të këtij testimi, subjektivit të rivlerësimit i rezervohet e drejta të ndjekë programin 2 vjeçar (nenin 165 i ligjit 96/2016) në shkollën e Magjistraturës	Relatori	
	nuk ka	Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentet provues. Miraton deklarimet e KPK mbi përfundimet e hetimit administrativ	Subjekti i rivlerësimit	
	nuk ka	Ankesa nga publiku	
Përfaqësuesi i ONM pyetet për pretendime, sqarime/ pyetje të mëtejshme nga kryetarja e trupit gjykues të KPK. Konfirmon se nuk ka pyetje për subjektin e rivlerësimit	Përfaqësuesi i ONM		
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektivit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Aksesi i pjesëmarrjes, nga publiku, shoqëria civile, institucionet e tjera të interesuara dhe mediat lokale është respektuar. Megjithatë, është krijuar praktikë procedurale urdhërimi i medias për të lënë sallën së bashku me pajisjet e regjistrimit, pas fazës përgatitore. Etika e sjelljes së trupit gjykues është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Pas çeljes së seancës dëgjimore, referuar nenit 55 të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar", përcaktohet trupa gjykuese dhe i jepet mundësia subjektivit të rivlerësimit të referoj publikisht gjeneralitetet dhe funksionin përkatës për identifikim. Kryetari i trupit gjykues parashton procedurën e seancës dëgjimore. I jepet e drejta procedurale subjektivit të rivlerësimit për të kundërshtuar konstatimet e KPK. I rezervohet e drejta e pyetjes vëzhguesit ndërkombëtar dhe trupës gjykuese nëse ka të tilla. Subjekti i rivlerësimit mundi të shpreh qëndrimin e tij përfundimtar për procesin e rivlerësimit. Referuar pikës 3 të nenit 55 të ligjit, subjektivit të rivlerësimit i njihet e drejta e të refuzoj dhënien e përgjigjes, si dhe në përputhje me nenin 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, i rezervohet e drejta e njohjes me materialet e dosjes. U prezantuan materialet e dosjes nga relatorja e çështjes. Subjekti është njohur me rezultatet përfundimtare të hetimit dhe dokumentacionin e administruar në dosje. I janë njohur të drejtat procedurale, që i njeh K.Pr.A., gjithashtu është njoftuar për procedurën e rivlerësimit dhe përbërjen e trupit gjykues, për të cilin ka deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Iu dhanë 5 ditë kohë për tu njohur me dosjen, duke i shoqëruar me të drejtën për të disponuar kopje të saj. Iu bënë të ditura rezultatet e hetimit administrativ. I rezervohet e drejta për të paraqitur shpjegime në formë zyrtare si dhe i jepet fjala për të paraqitur qëndrimet përfundimtare. I rezervohet e drejta përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, dhe trupit gjykues të drejtojnë pyetje. etj. Kohëzgjatja e seancës dëgjimore është e arsyeshme (25 minuta). Trupi gjykues tërhoqet për shpalljen e dispozitivit të vendimit, të nesërmen në dt. 08 nëntor, ora 10:00. Sa më sipër, seanca dëgjimore e subjektivit të rivlerësimit Znj. Miranda Nakaj, plotëson kriteret që referon ligji nr. 84/2016, Kodi i Procedurës Administrative dhe Aneksi shtojcë i Kushtetutës, referuar te drejtave procedurale dhe respektimit të elementeve përbërës të procesit të rregullt ligjor, mbrojtjes efektive, aksesit në gjykim, kohëzgjatjes së arsyeshme të seancës. Sa i takon administrimit të provave, referuar nenit 7 të ligjit (Të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve), pavarësisht legjitimit të KPK për të zhvilluar një proces të pavarur hetimor, enkas rezultateve të paraqitura nga institucionet kompetente (ILDKPI,DSIK,Inspektoriati KLD), u konstatua një tendencë për të zbutur vendimet negative të institucione raportuese. Konkretisht, nuk u parashtrua asnjë dokument provues, apo fakt në cilësinë e provës për të argumentuar kundërshtimin e vendimit të ILDKPI që vendos "Deklarim jo të saktë dhe jo në përputhje me ligjin". Arsyetimi se "në kuadër të hetimit administrativ, të pavarur e të gjithanshëm, konstatohet përputhje me deklaratat e subjektivit të rivlerësimit" nuk gjykohet të jetë arsyetim i mjaftueshëm. Tendenca për të detyruar Inspektoratin e KLD për të zhvilluar një vlerësim të dyte, në kundërshtim me vlerësimin e parë të dhënë (nga ku vlerësohet përshtatshmëria për të vazhduar detyrën, bazuar në mendimet e gjyqtarëve relator të së njëjtës gjykatë, nga ku evidentohen 2 të tilla, një pozitiv dhe tjetri negativ), nuk paraqesin shkak të bindshëm lidhur me vendimmarrjen e KPK tërësisht në kundërshtim me vendimet e institucioneve raportuese. Pavarësisht këtij gjykimi, do të pritet zbardhja e arsyetimit të vendimit për të evidentuar raste konkrete mospërputhje.</p>		